

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-064/14

**Prishtinë,
5 dhjetor 2014**

Në çështjen juridike të

M. K.

Serbi

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër.

N/A

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA35634 dhe KPA35655), të datës 14 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më on 5 dhjetor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. K.

- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012, e datës 14 dhjetor 2012, për sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA35634 dhe KPA35655.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 11 prill 2007 M.K. (më tej: pala ankueset), në cilësinë e anëtarit të familjes së ngushtë në emër të babait të tij të ndjerë, ka paraqitur dy kërkesa pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar që të njihet si pronar i ngastrave të ndryshme të tokës të fituar përmes trashëgimisë, ta rikthejë posedimin dhe të kompensohet për shfrytëzim të paligjshëm. Ai shpjegoi se këto ngastra i përkitnin babait të tij të ndjerë, Vukadin Krstić, dhe se ato ishin uzurpuar ilegalisht nga një person i panjohur. Ai deklaroi se posedimi i pronës ishte humbur më 9 shtator 1999 si rrjedhojë e konfliktit të armatosur.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai paraqiti në AKP dokumentet lidhur me gjendjen e tij civile dhe gjendjen civile të prindërve të tij si në vijim:
 - Certifikatën e tij të lindjes të lëshuar më 14 janar 2000 nga Republika Federale e Jugosllavisë, Republika e Serbisë, Komuna e Rahovecit, që tregon vendin e tij të lindjes në Zoqishtë, Rahovec, emri i babait të tij si **“K” K** dhe data e lindjes së babait të tij si **10 maj 1915**;
 - Letërnjoftimin e tij të lëshuar më 2 nëntor 1999, që tregon emrin e babait të tij si **“K” K**
 - Certifikatën e vdekjes të lëshuar më 11 shtator 2001 për **V. K.**, që tregon se ai ka lindur më **19 maj 1915** dhe ka vdekur më 28 gusht 2001 në Kragujevac.
3. Lidhur me ngastrat që ai pretendon se i ka trashëguar nga Vukadin Krstić, dokumentet që ai i ka paraqitur në AKP janë si në vijim:

Numri i ankesës dhe lëndës në AKP	Të dhënat e ngastrës së kërkuar	Dokumentet e paraqitura
GSK-KPA-A-064/14 (lënda KPA35634)	Ngastra nr. 141 prej 1673 m ² , që ndodhet në Retijë, Rahovec,	Fleta Poseduese nr. 163 e lëshuar nga Komuna Kadastrale

	pronë komerciale pa objekte, kullotë e klasit të dytë	e Rahovecit, Zona Kadastrale Retijë, që tregon se ngastra i përket për 1/1 V.S. K.
GSK-KPA-A-065/14 (lënda KPA35655)	Ngastra nr. 1052/2 prej 1189 m ² , që ndodhet në Zoqishtë, Rahovec, pronë komerciale pa objekte, kullotë e klasit të tretë	Fleta Poseduese nr.68 e lëshuar nga Komuna Kadastrale e Rahovecit, Zona Kadastrale Zoqishtit, që tregon se ngastra i përket për 1/1 V. S.K.

Certifikata e vdekjes dhe fletat poseduese nr.68 dhe 163 janë verifikuar.

4. Më 27 nëntor 2007 (KPA35634), AKP e bëri njoftimin e pronës duke vendosur një shenjë në vendin ku pretendohet se ndodhet ngastra, duke shënuar se prona është objekt i një kërkese dhe se palët e interesuara duhet t'i paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditësh. Askush nuk u përgjigj ndaj këtij njoftimi. Më 1 korrik 2010, AKP përsëri bëri njoftimin e pronës duke e publikuar në Gazetën e Njoftimeve nr. 3 dhe në Buletinin e Pronave të UNHCR-së. Gazeta dhe Lista janë lënë te kryetari i fshatit i cili u pajtua që ato t'ua dorëzojë palëve të interesuara, si dhe në hyrje dhe dalje të fshatit Retijë. Këto publikime gjithashtu janë lënë në të gjithat gjykatat e komunës si dhe gjykatat komunale të rajonit, në zyrën kadastrale në Prizren, UNHCR, CPRK, EULEX, OMBUDSPERSON dhe ICO.
5. Më 30 shtator 2010 (KPA35655), zyrtarët e AKP-së shkuan në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kontestuara dhe vendosën shenjat që tregonin se prona ishte objekt i një kërkese dhe se palët e interesuara duhet t'i paraqesin përgjigjet e tyre brenda një muaji. Ata vërejtën se prona e kërkuar nuk ishte e uzurpuar. Më vonë në procedurë, AKP kontrolloi njoftimin dhe ka mundur të vërtetojë se njoftimi ishte bërë si duhet, duke u bazuar në ortofotot dhe koordinatat GPS.
6. Pasi që asnjë palë përgjegjëse në kërkesë nuk kishte paraqitur përgjigje brenda afatit kohor, të dy kërkesat u konsideruan si të pakontestuara.
7. Meqë në certifikatën e lindjes së palës ankuese shënonte se emri i babait të tij ishte "K", ndërkaq Fletat poseduese tregonin emrin e pronarit si "V" dhe po ashtu emri i të ndjerit në certifikatën e vdekjes ishte "V", Njësia e Informatave të AKP-së e kontaktoi paraqitësin e kërkesës më 10 mars 2008, 22 korrik 2008, 14 tetor 2008 dhe 24 shkurt 2010 duke kërkuar nga ai që t'i paraqes deklaratat e dëshmitarëve lidhur me emrin e babait të tij. Secilën herë, paraqitësi i kërkesës i informonte ata se do t'i dorëzonte dokumentet e nevojshme brenda afatit prej 30 ditësh. Paraqitësi i ankesës u kontaktua përsëri më 8 maj 2009 dhe 26 prill 2010 dhe secilën herë atij i është dhënë afati prej 30 ditësh që të dorëzojë një dokument të

- vërtetuar nga zyra e regjistrimit civil për ta shpjeguar këtë mospërputhje, përndryshe kërkesa e tij do të hidhej poshtë. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se do ta ndryshojë letërnjoftimin dhe certifikatën e tij të lindjes dhe do t'i dorëzojë dokumentet e ndryshuara brenda afatit. Mirëpo, paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur t'i paraqes këto dokumente.
8. Më 14 dhjetor 2012, KKPK me një vendim grupor hodhi poshtë kërkesat në mungesë të dëshmisë së aftësisë së palës ankuese që të paraqes kërkesë në emër të bartësit të drejtës pronësore (KPCC/D/A/180/2012). Në arsyetimin e vendimit të saj, KKPK tregon se “[...] *Kërkesat, në të cilat nuk mund të vërtetohet një marrëdhënie e pretenduar e familjes së ngushtë ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe bartësit të drejtës pronësore, nuk mund të konsiderohen kërkesa të kompletuara në përputhje me nenin 5.2 të UNMIK/ADM/DIR/2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. [...] Kërkesat nr. KPA35634 dhe KPA35655 janë parashtuar nga Paraqitësi i kërkesës në emër babait të tij, bartësit të drejtës pronësore. Emri i bartësit të drejtës pronësore është i regjistruar si V.K. në fletën poseduese dhe në certifikatën e vdekjes të dorëzuar me kërkesën, ndërsa në letërnjoftim dhe në certifikatën e lindjes të paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës, emri i babait të tij është i shënuar si K. K. Paraqitësi i kërkesës është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive në pesë raste të ndryshme gjatë viteve 2008 dhe 2009 për ta qartësuar mospërputhjen e emrit dhe nga ai është kërkuar që të dorëzojë dokumente nga institucionet kompetente për ta shpjeguar mospërputhjen. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai do t'i paraqes dokumentet e nevojshme dhe do të ndërmerr hapa për korrigjimin e emrit dhe babait të tij në regjistrat zyrtar pasi që emri i babait të tij është V, jo K. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të paraqes ndonjë provë shtesë. Në mungesë të provave që konfirmojnë marrëdhënien familjare ndërmjet Paraqitësit të kërkesës dhe bartësit të drejtës pronësore, kërkesa e Paraqitësit të kërkesës duhet të hidhet poshtë”.*
9. Më 5 nëntor 2013, Vendimi iu dorëzua Mladjan Krsitćit. Ai paraqiti ankesë pranë Gjykatës Supreme më 20 nëntor 2013.
10. Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme vëren se tetë (8) ankesa të ndërlidhura të palës ankuese ishin refuzuar më herët (GSK-KPA-A-36/11) mbi bazën e njëjtë si shpjegimi më lartë.

Pretendimet e paraqitësit të kërkesës/palës ankuese

11. Pala ankuese pretendoi se vendimi i KKPK-së mbështetet në faktet që nuk janë vërtetuar plotësisht dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Ai deklaroi se komisioni, në vendimin e ankuar, iu ka referuar dy vendimeve të veta të mëhershme: KPCC/D/A/84/2010 dhe KPCC/D/A/61/2010. Ai nuk e ka kontestuar faktin se Komisioni, në kohën kur i ka marrë vendimet e lartcekura, nuk ka pasur prova të tilla. Megjithatë, në kohën kur është marrë vendimi i ankimuar, Komisioni i kishte dokumentet e

domosdoshme kështu që ka mundur të merr vendim me të cilin do t'i konfirmonte të drejtat e tij mbi pronën e kërkuar. Ai pretendon se ai e kishte filluar një procedurë për korrigjimin e librit për regjistrimin e lindjeve dhe se kjo procedurë, jo me fajin e tij, kishte zgjatur shumë. Në fund, ai deklaroi se ka arritur që t'i korrigjoj të dhënat e veta dhe në ankesat kundër vendimeve të mëparshme KPCC/D/A/84/2010 dhe KPCC/D/A/61/2010, ai e kishte paraqitur një certifikatë të dytë të lindjes të lëshuar më 28 tetor 2010. Prandaj, Komisioni ka qenë në posedim të provave para se të merr vendimin KPCC/D/A/180/2012 të datës 14 dhjetor 2012.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është paraqitur brenda 30 ditësh sikurse parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Gjykata Supreme ka juridiksion mbi ankesën kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Bashkimi i ankesave:

13. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
14. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurën pranë Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribuon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.
15. Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 2 (dy) lëndët. Vetëm ngastrat, objekte të së drejtës pronësore të cilat pretendohen në secilën

kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.

16. Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-064/14 deri në GSK-KPA-A-065/14 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-064/14

Meritat e ankesës

17. Pas shqyrtimit të shkesave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në përputhje me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, Gjykata Supreme konstatoi se ankesa është e pabazuar.
18. Pala ankuese nuk ka dëshmuar se ai është i biri i bartësit të drejtës pronësore dhe si i tillë ose si anëtar i familjes së ngushtë ka mundur të ushtrojë kërkesë në emër të babit të tij (të ndjerë) apo si trashëgimtar i babait të tij të ushtroj kërkesë në emër të tij.
19. Neni 5.2 i Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2007/5 (UNMIK/DIR/2007/5) e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parasheh si në vijim: *“Në procedurat para Komisionit, kur personi juridik nuk mund të bëjë kërkesën, e njëjta mund të bëhet nga anëtar i familjes së atij personi”*.
20. Pala ankuese këtu deklaron se ai është i biri i pronarit të ndjerë të pronës. Por, ai nuk ka dorëzuar në KKKP por vetëm në Gjykatë në shkallën e apelit një certifikatë të lindjes që tregon emrin e babait të tij që është emri i pronarit të ndjerë të pronës: “V” K.
- a. Neni 12.11 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 parasheh që *“Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë”*. Duket mjaft e diskutueshme nëse vetëm pretendimi i palës ankuese se ai nuk kishte qenë në gjendje të pajiset me certifikatën e lindjes më herët është e mjaftueshme për t’i përmbushur kushtet e ligjit. Por edhe nëse Gjykata e lejon këtë provë të re dhe e merr parasysh, ajo nuk mjafton për të dëshmuar se pala ankuese është i biri (dhe rrjedhimisht anëtar i familjes së ngushtë në kuptim të UNMIK/DIR/2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) i bartësit të drejtës pronësore.
 - b. Gjykata duhet të vendos nëse certifikata e lindjes e lëshuar më 28 tetor 2010 është lëshuar nga autoriteti kompetent. Edhe po të ishte lëshuar nga një autoritet kompetent, kjo nuk jep dëshmi se pronari i ndjerë i pronës ka qenë babai i palës ankuese.

certifikata e vdekjes së bartësit të drejtës pronësore jep emrin e tij si V. K dhe datën

e tij të lindjes si **19 maj 1915**. Po ashtu, në kërkesën e tij pala ankuese ka dhënë datën e lindjes të babait të tij si **19 maj 1915**. Megjithatë, certifikata e parë e palës ankuese jep emrin e babait të tij si Kostadin Krstić dhe datën e tij të lindjes si **10 maj 1915**. Edhe pas korigjimit, certifikata e lindjes e lëshuar më 28 tetor 2010 jep datën e lindjes së babait të paraqitësit të kërkesës si **10 maj 1915**. Kjo datë e lindjes nuk është e njëjtë si data e lindjes së pronarit të ndjerë të pronës, që është 19 maj 1915. Gjykata e kupton se gabimet mund të ndodhin dhe se një datë e lindjes mund të kopjohet gabimisht nga regjistri. Sidoqoftë, gabimi është më pak i mundshëm në rastet ku data e lindjes është shkruar dy herë pa ndryshim. Kështu që, Gjykata duhet të konkludoj se ose certifikata e lindjes është dëshmi se data e lindjes e babait të palës ankuese nuk është data e lindjes së bartësit të drejtës pronësore dhe se këta nuk janë personi i njëjtë ose Gjykata mund të supozojë se certifikata e dytë e lindjes nuk e jep shënimin në regjister por është vetëm një version i korigjuar i certifikatës së parë të lindjes. Në të dy rastet, nuk ka dëshmi se pala ankuese është i biri i bartësit të drejtës pronësore.

21. Ky argumentim po ashtu vlen edhe nëse pala ankuese dëshiron ta kërkojë pronën në emrin e tij. Gjykata nuk ka dëshmi se ai është i biri i bartësit të ndjerë të drejtës pronësore.
22. Prandaj, vendimi i ankuar as nuk mbështetet në faktet të vërtetuara në mënyrë të mangët e as në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
23. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, ankesa është dashur të refuzohet si e pabazuar dhe të konfirmohet vendimi i KKKP-së sa i përket lëndëve për të cilat është vendosur në këtë Aktgjykim (KPA35634 dhe KPA35655).

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva - Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it